



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

Numër: 01-425  
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 15.09.2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet DBBS Sh.P.K në Prizren me adresë Rruga "Ismet Jashari" nr. 32, për periudhën 15.09.2017 deri 15.09.2020 me kualifikimet:
  - 1.1. **Metalpunes, Niveli III sipas KKK me 120 kredi të AAP.**
  - 1.2. **Instalues elektrik, Niveli III sipas KKK me 112 kredi të AAP.**
2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për kualifikimet:

### **Metalpunes**

- 2.1. Pajisja e punëtorisë me makina metalpunesë (torno, frez, sharrë, retifikë, etj) të cilat akoma nuk kanë arritur në destinim përfundimtar (sipas njoftimit nga zyrtarët e DBBS gjenden në Doganë).
- 2.2. Përgatitja e planit/ vjetor për implementimin dhe monitorimin e vlerësimit të kualifikimit.
- 2.3. Trajnimi i stafit mësimdhënës në didaktikë profesionale dhe pedagogji.
- 2.4. Përgatitja e planit vjetor për vlerësimin dhe verifikimin e brendshëm.
- 2.5. Zhvillimi i dokumentacionit me procedurat për identifikimin e nevojave për trajnim të trajnerëve, instruktoreve apo edhe mësimdhënësve.
- 2.6. Zhvillimi i formularë për raportim të incidenteve.
- 2.7. Të vendosen instruksionet neper stacione punuese.
- 2.8. Të përgatitet lista ngarkuese /shkarkuese e lëndës së parë, pajisjeve sipas nevojës.

2.9. Të përgatiten formularët për dosjen e kandidatit ku do të regjistrohen dëshmitë e projekteve të realizuara nga ta, si brenda ashtu edhe jashtë DBBS SH.P.K. gjatë realizimit të punës praktike.

2.10. Unifikimi i politikave dhe proceduarve të institucionit në një dokument të përbashkët.

### **Instalues elektrik**

2.1. Të përgatitet plani vjetor për implementimin dhe monitorimin e vlerësimit të kualifikimit.

2.2. Të hartohen mekanizma dhe formularë për identifikimin e nevojave për zhvillim të stafit, e sidomos për zhvillimin dhe trajnimin e trajnerit.

2.3. Të hartohen formularë për evidentimin dhe raportimin e incidenteve.

2.4. Të hartohen dhe të vendosen instruksione për masat e sigurisë nëpër panele punuese.

2.5. Në portofoliot e kandidatëve të përfshihen edhe dëshmi të projekteve të realizuara nga puna praktike, si brenda ashtu edhe jashtë qendrës.

2.6. Të bëhet trajnimi i trajnerit në didaktikë profesionale dhe pedagogji.

2.7. Lista e teksteve dhe paketave mësimore të propozuara për përdorim janë kryesisht libra universitar të botuar përgjatë dy-tre dekadave të fundit. Të hartohen ose të merren paketa mësimore për modulet profesionale të cilat bazohen në standard dhe kanë rezultatet e mësimin konform standardit.

2.8. Të krijohet procedurë apo politikë e cila parasheh kushtet, kriteret dhe afatet rreth mundësisë së ritestimit për kandidatët të cilët nuk e kalojnë me sukses modul/kualifikimin.

2.9. Të krijohet procedurë apo politikë e cila parasheh kushtet, kriteret dhe afatet rreth mundësisë së ritestimit për kandidatët të cilët nuk e kalojnë me sukses modul/kualifikimin.

2.10. Të përpilohet procedura për njohjen e kredive nga institucione të tjera.

2.11. Bombolat me gaz të cilat janë te dritarja/dera e laboratorit për Instalime Elektrike, e të cilat përdoren për punë praktike të laboratorëve të tjerë të zhvendosen ose të sigurohen sepse mund të rrezikojnë kandidatët.

2.12. Në marrëveshjet për punë praktike me kompanitë dhe në kontratën me kandidatë të specifikohet saktë dhe qartë obligimi i kompanisë, qendrës DBBS dhe kandidatit.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datat 15.11.2017 sipas raporteve të jashtme vlerësuese për secilin kualifikim. Në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kriteret, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

## Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në diapozitivin e këtij vendimi.

### Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi u dërgohet:
  - DBBS;
  - AKK.

Bedri Xhafa  
Kryetari i KD së AKK-së

